

**KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT  
“HIDRODRINI” SH.A. PEJË**

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 21 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Komisioni i Auditimit të KRU "Hidrodrini" SH.A. shpall:

**KONKURS PUBLIK**

**Për plotësimin e vendit të punës:**

**ZYRTAR/E PËR AUDITIM TË BRENDSHËM**

**Numri i referencës: 155**

**Emërtimi:** Zyrtar i Auditimit të Brendshëm  
**Vendi:** Pejë  
**Ndërmarrja:** Kompania Rajonale e Ujësjiellësit “Hidrodrini” Sh.A. Pejë  
**I përgjigjet:** Komisionit të Auditimit  
**Paga:** Sipas Rregullores në fuqi  
**Kohëzgjatja:** Për kohë të caktuar / periudha provuese gjashtë (6) muaj

**Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:**

Komisioni i Auditimit dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencialë të jenë persona me integritet të lartë të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (k) dhe (l) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë. Përveç këtyre kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Të ketë diplomë universitare me të paktën 240 kredi/ECTS ose ekuivalente, në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike apo fusha të tjera të studimeve relevante. Diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Të ketë certifikatë të auditorit të brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave (dëshmi);
- Të jetë ekspert i certifikuar në kontabilitet apo ndonjë fushë tjetër në kuadër të financave;
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në fushën e auditimit/financave ose kontabilitetit (së paku 3 vite në nivel menaxhues). Preferohen kandidatë me përvojë pune në ndërmarrje / korporata të tjera me madhësi dhe kompleksitet të lartë;
- Të posedojë integritet të lartë moral e profesional;
- Të jetë objektiv e i pa-anshëm;
- Të njohë mirë ligjet dhe rregulloret në fuqi, me theks të veçantë Ligjin për NP dhe ligjet tjera që kanë



të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e financave;

- Të ketë aftësi të komunikimit, planifikimit të punës dhe udhëheqjes të aktiviteteve të auditimit;
- Të ketë aftësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Të ketë shkathtësi bashkëpunimi me menaxhmentin dhe personelin e kompanisë;
- Të ketë aftësi të delegimit dhe monitorimit të autoritetit dhe përgjegjësisë tek bashkëpunëtorët për kryerjen e funksioneve të deleguara;
- Të ketë njohuri të avancuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe pakove standarde softuerike;
- Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi.

#### **Përshkrimi i detyrave të punës:**

- Të zhvillojë vazhdimisht njohuritë dhe shkathtësitë profesionale dhe të ruajë certifikimin e vet profesional, duke marrë pjesë në gjashtëdhjetë (60) orë trajnim brenda dy (2) viteve të njëpasnjëshme, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 2 të Ligjit nr.06/L-021;
- Të rrisë dhe mbrojë vlerën e organizatës, duke ofruar siguri përmes auditimit dhe këshillave të bazuara në rrezik dhe në objektiva;
- Të menaxhojë dhe organizojë funksionimin e auditimit sipas Standardeve Ndërkombëtare;
- Të promovojë kulturë etike në ushtrimin e profesionit të auditimit të brendshëm duke respektuar parimet bazike dhe rregullat e sjelljes të përcaktuara me Kodin e Etikës;
- Të hartojë dhe propozojnë planin strategjik dhe vjetor të auditimit të brendshëm të kompanisë;
- Të raportojë për procesin e auditimit sipas planit të auditimit dhe të monitorojë zbatimin e rekomandimeve sipas planit të veprimit;
- Të planifikojë proceset e auditimit përmes të cilave vlerësohen kontrollet e brendshme dhe performanca, në pajtueshmëri me standardet profesionale;
- Të përgatitë dhe ekzekutojë programe auditimi për të kryer auditime sipas planit vjetor, duke përcaktuar objektivat e auditimit dhe duke identifikuar rreziqet;
- Të përgatitë raportet e auditimit që pasqyrojnë qartë objektivat e auditimit, fushëveprimin gjetjet, rekomandimet, konkluzionet;
- Të bashkëpunojë ngushtë me Komisionin e Auditimit dhe të zbatojë detyra të përgjithshme dhe specifike me kërkesë të komisionit, si dhe të jap llogari për punët e dhëna;
- Të ketë integritet personel, kompetencë, fleksibilitet dhe kujdes të shtuar profesional;
- Të përshtatet me strategjinë, objektivat dhe rreziqet e kompanisë;
- Të jetë proaktiv dhe i fokusuar në të ardhmen, që të rekomandojë dhe këshillojë vazhdimisht përmirësimin e kontrollit të brendshëm të kompanisë;

#### **Procedura për aplikim:**

- Aplikacioni i cili mund të shkarkohet nga uebfaqja e kompanisë ([www.kru-hidrodrini.com](http://www.kru-hidrodrini.com));
- Një CV e detajuar (preferohet në shabllonin Europass);
- Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës;
- Letër motivimi (maksimum 500 fjalë);
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale / diplomat dhe certifikatat (kopje të noterizuara);
- Kopjet e certifikimeve përkatëse;



- Dëshmi për përvojën e punës / vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë;
- Pasqyrat e kontributeve pensionale (nuk kërkohet për përvojat e punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe për ato përvoja kur punëdhënësit nuk kanë qenë të detyruar të paguajnë në këtë institucion);
- Deklarata nën betim sipas neneve 17.1 dhe 17.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike;
- Certifikatë nga gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i dënuar për kryerjen e ndonjë vepre penale (jo më e vjetër se gjashtë muaj nga data e lëshimit);

#### **Informata të përgjithshme:**

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët që plotësojnë kriteret arsimore dhe profesionale sipas konkursit;
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit;

Dokumentacioni i kompletuar dërgohet i skanuar (në cilësi të mirë) në postën el: [www.kru-hidrodrini.com](http://www.kru-hidrodrini.com) dhe në kopje fizike në zarf të mbyllur në adresën: Rr. "Lekë Dukagjini" nr.156 - Pejë (afër Patrikanës së Pejës) në KRU "Hidrodrini" Sh.A. Dokumentet origjinale mund të kërkohen me rastin e intervistimit.

Inkurajohen të aplikojnë femrat dhe pjesëtarët e komuniteteve pakicë.

Konkursi publikohet në mjetet e informimit publik në shtypin ditor "Koha Ditore" si dhe në dhe Web – faqen "Hidrodrini" Sh. A. [www.hidrodrini.com](http://www.hidrodrini.com).

Konkursi mbetet i hapur Tridhjetë (30) ditë kalendarike nga data **09.03.2023**, afati i fundit për aplikim është deri më **07.04.2023** në ora **16:00h**.

**Vërejtje:** Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tre (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen. Do të kontaktohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe që përfshihen në listën e ngushtë.

Kandidati/ja i/e përzgjedhur obligohet të sjellë certifikatën mbi aftësinë mjekësore për të vepruar (Lëshuar nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale) para nënshkrimit të kontratës.